

ASC-09-0067

Në padinë e

1. [REDACTED], fshati Surqine, Ferizaj; Ankuesit
2. [REDACTED], fshati Rahovicë, Ferizaj;
3. [REDACTED], fshati Nekodim, Ferizaj;
4. [REDACTED], Ferizaj;
5. [REDACTED], fshati Pleshinë, Ferizaj;
6. [REDACTED], fshati Varosh, Ferizaj;
7. [REDACTED], Ferizaj;
8. [REDACTED], Ferizaj;
9. [REDACTED], fshati Prelezi i Jerlive, Ferizaj;
10. [REDACTED], Ferizaj;
11. [REDACTED], fshati Greme, Ferizaj;
12. [REDACTED], Ferizaj.

kundër

Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Apeluesja/E paditura

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), Kolegji i Ankesave i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 09 mars 2010 lëshon këtë

AKTVENDIM:

Ankesa refuzohet si e pabazë.

Vërtetohet aktvendimi i Trupit Gjykues (SCEL-09-0011) i datës 17 shtator 2009, me anën e të cilit lista e punëtorëve me të drejta legjitime u shpall nullë dhe e pavlefshme.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Më 17 shtator 2009, Trupi Gjykses e lëshoi një aktvendim duke e shpallur listën e punëtorëve me të drejta legjitime nullë dhe e shpallë të pavlefshme në të njëjtën kohë. Trupi Gjykses më tej i ndërpreu procedurat në këtë lëndë dhe e udhëzoi Apeluesen/të Paditurën të publikojë listë të re sipas ligjit.

Apeluesja/ e Paditura e parashtroi ankesë kundër këtij aktvendimi më 23 tetor 2009. Në të argumentohet se aktvendimi përbënë shkelje të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 dhe paraqiten fakte dhe dëshmi të reja.

Në të thuhet se AKP-ja e ka njoftuar me kohë Kryetarin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme me anë të letrës së datës 28 shtator 2009, për emërimin nga ICO-ICR/EUSR të Kryesuesit Ndërkombëtar dhe (në të njëjtën kohë) Anëtar Ndërkombëtar i Komitetit për Shqyrtim në AKP.

Apeluesja/e Paditura pohon në mënyrë specifike se ajo ishte udhëzuar nga Dhoma e Posaçme në lëndën SCEL-09-001 (Ramiz Sadiku) se nuk kishte nevojë që lista të publikohej përsëri. Ajo pohon se Dhoma e Posaçme ka bërë precedent. Prandaj Apeluesja/e Paditura kërkon të ndryshohet aktvendimi i Trupi Gjykses në atë mënyrë që të publikimi i serishëm i listës së re të jetë e panevojshme.

Për më tepër Apeluesja/e Paditura thotë se pas aktvendimit të kontestuar dhe pas themelimit të Komitetit për Shqyrtim të Listës së Punëtorëve u shqyrtua lista e NSH-së "LUBOTENI", dhe asnjë ndryshim nuk është bërë në krahasim me listën e mëhershme.

Megjithatë, pasi që ankesa e Apelueses/të Paditurës nuk u plotësua, Dhoma e Posaçme më 13 nëntor 2009 e lëshoi një urdhër, me anën e të cilit kërkoi që Apeluesja/e Paditura në pajtim me nenin 60.2 të UA-së të UNMIK-ut 2008/6 të dorëzojë kopjen e aktvendimit kundër së cilit është ushtruar ankesa, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga njoftimi i pranimi të këtij urdhri, si kusht për pranueshmërinë e ankesës.

III

Me anë të këtij urdhri Apeluesja/ e Paditura gjithashtu u informua qartë se Trupi Gjykses nuk obligohet ligjërisht nga aktvendimet e veta të mëhershme. Kolegji i Ankesave po ashtu nuk ka mundur të sheh ndonjë arsye që Apeluesja/e Paditura të mos jetë e obliguar të veprojë në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 në lëndët në të cilat lista origjinale u shpall nullë dhe e pavlefshme nga DHPGJS-ja.

Apeluesja/e Paditura iu përgjigj urdhrit të DHPGJS-së më 14 dhjetor 2009, duke e dorëzuar kopjen e aktvendimit me anën e të cilit u pezullua procedura për SCEL-09-0011, derisa të publikohet lista e re në përputhje me ligjin. Aktvendimi vetëm ndaloi procedurën në lëndën deri në ditën "kur të publikohet lista e vlefshme e punëtorëve në pajtim me ligjin". Kjo nuk përfshinë ndonjë aktvendim tjetër. Apeluesja në parashtresën e saj të datës 22 tetor 2009, (për aq sa përkthimi në anglisht mundësonte gjykimin në të), dukej të atakonte aktvendimin e Trupit Gjykses i cili e shpalli listën e mëhershme si nullë dhe të pavlefshme, pasi që ai kërkonte në mënyrë eksplicite ndryshimin e atij aktvendimi.

Për shkak të kësaj parashtrese, ankesa nuk është e qartë, kështu që me urdhrin e dytë të datës 21 dhjetor 2009, DHPGJS-ja kërkoi nga Apeluesja/e Paditura që, brenda 7 (shtatë) ditëve të paraqes sqarim në lidhje me parashtresën e saj të datës 14 dhjetor 2009.

Apeluesja/e Paditura iu përgjigj urdhrit të Gjykatës më 29 dhjetor 2009, duke e dorëzuar kopjen e aktvendimit me anën e të cilit lista e punëtorëve u shpall nullë dhe e pavlefshme.

Kolegji i Ankesave e ka parë të nevojshme të lëshojë është urdhrin e tretë më 13 janar 2010, duke kërkuar nga Apeluesja/e Paditura që brenda 3 (tri) ditëve nga pranimi i këtij urdhri të dorëzojë sqarim në lidhje me parashtresën e datës 14 dhjetor 2009 dhe parashtresën e datës 29 dhjetor 2009, pasi që Apeluesja/e Paditura nuk ka arritur të sqarojë këtë, sipas kërkesës së Urdhrit të Gjykatës më datën 21 dhjetor 2009, kundër të cilit Aktvendim të Trupit Gjykses të datës 17 shtator 2009 është drejtuar ankesa e saj. Po ashtu iu kërkua Ap elueses/të Paditurës që të pohojë qartë se cilin Aktvendim ka për qëllim ta kontestojë, apo

nëse ka për qëllim t'i kontestojë që të dy. Po ashtu duhet të theksohet qartë se deri në çfarë shkalle Apeluesja/e Paditura kërkon modifikimin e Aktvendimit(eve) e/të kontestuar(a).

Arsyetimi Ligjor:

Ankesa është e pranueshme po e pabazuar. Në bazë të nenit 63.2 të UA-së të UNMIK-ut 2008/6, Kolegji i Ankesave vendosi që ta refuzojë pjesën gojore të procedurës.

Neni 67.5 i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut (UA) 2008/6 precizon se lista finale e punëtorëve që e gëzojnë të drejtën, e vendosur nga Bordi i Drejtorëve në përputhje me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, dhe e hartuar në bazë të nenit 67.2 deri në 67.5 të UA-së të UNMIK-ut 2008/6, do të publikohet në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Kjo do të thotë se ndër kërkesat për një listë të vlefshme është publikimi në përputhje me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, e që nënkupton publikimin në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavën vijuese në gazetatat kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë dhe në gazetatat kryesore në gjuhën serbe.

Një listë është në përputhje me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 nëse shqyrtohet dhe rregullohet nga Agjencia.

Pasi që AKM-ja si Agjenci, në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Kosovë, duhet të jetë ajo e cila merret me privatizimin e NSH-ve dhe ndarjen e 20% për punëtorët më të drejta legjitime nuk vepron më në këtë fushë të përgjegjësive të saj, dhe pasi që Apeluesja i ka marrë ato përgjegjësi në bazë të "Ligjit për Agjencinë e Privatizimit të Kosovës" (Ligji nr. 03/L-067) (jo i aplikueshëm drejtpërdrejtë), Dhoma e Posaçme i pranon aktivitetet e AKP-së si fakt të qartë për t'iu mundësuar punëtorëve që u nënshtrohen procesit të privatizimit që të kenë qasje efikase në gjykatë në kuptim të Nenit 6 të KEDNJ-së. Kjo nuk nënkupton se Dhoma e Posaçme e pranon ligjin e AKP-së si ligj të aplikueshëm në Kosovë. Megjithatë, për të siguruar proces të drejtë dhe të sigurt të privatizimit "Ligji" i AKP-së duhet të trajtohet si i vlefshëm dhe obligues për rregullat e brendshme të organizatës brenda procesit të privatizimit. AKP-ja, që faktikisht vepron si

pasardhëse e AKM-së në fushën e privatizimit, atëherë duhet – së paku në këtë kontekst- të respektojë rregullat e përcaktuara në ligjin e AKP-së.

Neni 24.1 i Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) (Ligji nr. 03/L-067), në pajtim me të cilin është themeluar AKP-ja si entitet faktik, përcakton se, Agjencia do të themelojë Komisionet Shqyrtuese. Këto Komisione Shqyrtuese do të kenë tre anëtarë, njëri ndër të cilët është anëtar ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (neni 24.2 të Ligjit për AKP-në). Ky person e kryeson Komisionin Shqyrtues (neni 24.2 të Ligjit për AKP-në). Çdo person i dëmtuar nga një veprim ose lëshim i Agjencisë ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim për shqyrtimin e veprimit ose vendimit nga një Komision Shqyrtues. Neni 24.7 i Ligjit për AKP-në përcakton se secili vendim përfundimtar i Agjencisë, duke përfshirë Komisionet e saj Shqyrtuese, mund të kundërshtohet para Dhomës së Posaçme. Kjo tregon se AKP-ja ka organizuar rishikimin e saj të brendshëm në kuptimin që Komisioni Shqyrtues siç përshkruhet në ligj është përgjegjës për shqyrtimin sipas nenit 10.2 të RREG UNMIK-ut 2003/13 dhe se lista është përfundimtare atëherë kur të jetë shqyrtuar nga Komisioni Shqyrtues.

Në lidhje me listën e shqyrtuar nga Komisioni Shqyrtues pas themelimit të tij, dhe të cilën Apeluesja pohon të bëjë përmbushjen e kërkesave të përmendura më lartë për një shqyrtim të vlefshëm të listës, kërkesa për publikim në bazë të nenit 10.3 të Rregullores nuk është përmbushur. Fakti që lista ishte identike nuk është relevant, sepse lista është finale vetëm kur të jetë shqyrtuar.

Sa i përket publikimit të listës finale të punëtorëve me të drejta legjitime pas themelimit të Komisionit Shqyrtues, Apeluesja/e Paditura i referohet SCEL-09-001 (Ramiz Sadiku) si precedent. Në SCEL-09-001 (Ramiz Sadiku), Kolegji i Ankesave asnjëherë nuk është marrë me çështjen e ngritur në këtë lëndë, sepse Apeluesja/e Paditura e kishte tërhequr ankesën e saj. Prandaj, Apeluesja/e Paditura nuk mund të pohojë se ka mungesë konsekuence të praktikës së gjykatës. Është e rëndësishme të shënohet se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme nuk obligohet nga aktvendimet e lëshuara nga Trupi Gjykes i Dhomës së Posaçme, si dhe Trupi Gjykes nuk obligohet nga aktvendimet e veta të mëhershme.

Ankesa, prandaj, refuzohet si e pabazë. Aktvendimi i lëshuar nga Trupi Gjykues më 17 shtator 2009 mbeten në fuqi. Vendimi për shpenzime nuk do të duhej të merrej.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it [nënshkruar]

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it [nënshkruar]

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it [nënshkruar]

Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it [nënshkruar]